



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Pasqyrë e përgjithshme për efektet e masës mbrojtëse

Korrik, 2018

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS

Përmbajtja

Metodologjia	3
Analizë/rezultatet e pyetësorit.....	4
Analizë e përgjithshme.....	4
Analizë sektoriale	7
Sektori prodhues i pemëve dhe perimeve.....	7
Sektori përpunues i pemëve dhe perimeve	8
Sektori i tregtisë i pemëve dhe perimeve.....	9
Përmbledhje e përgjithshme / Konkluzione	10

Metodologjia

Oda Ekonomike e Kosovës është një institucion që i shërben ekonomisë Kosovare, konkretisht komunitetit të biznesit. Është partner konstruktiv i institucioneve shtetërore të Republikës Kosovës, partner në dialogun social si dhe promotor i zhvillimit ekonomik dhe politikave të mira makroekonomike.

Si një organizatë legjitime e përfaqësimit të interesave të komunitetit të biznesit në Kosovë. Oda Ekonomike e Kosovës ka realizuar një analizë të shpejt me qëllim të matjes së efekteve të masës së përkohshme mbrojtëse në import të pemëve dhe perimeve. Bizneset kosovare të cilat importojnë këto 7 produkte domate, speca, molla, dardha, kumbulla, mjedra dhe rrush duhet të paguajnë 30 % të vlerës së doganës. Ky vendim për caktim të masës mbrojtëse doganore është bërë me qëllim të mbrojtjes së prodhuesve vendor.

Për realizimin e kësaj analize është përdorur një mostër prej 15 kompanive, mostra është ndarë në tri pjesë e cila përbëhet prej kompanive që si veprimtari kryesore të tyre e kanë ***prodhimin, përpunimin dhe tregtimin*** e pemëve dhe perimeve. Pjesëmarrëse në hulumtim ishin kompani të cilat janë eminente në këtë fushë. Andaj, mund të thuhet se mostra i plotësojnë kriteret për të qenë përfaqësuese e popullacionit.

Mbledhja e informacionit është bërë përmes një pyetësori të hartuar online, me qëllim të arritjes në mënyrë sa më të shpejt të informacioni. Rreth vlerësimit të efekteve të kësaj mase mbrojtëse informacioni është marrë nga niveli i lartë i menaxhmentit të këtyre kompanive. Shumica e pyetjeve ka qenë e fokusuar në opsione.


Informacioni që rrjedh nga ky hulumtim ndihmon të kuptohen efektet që ka pasur kjo masë mbrojtëse të bizneset që merren me prodhim, përpunim dhe tregtim të pemëve dhe perimeve. Po ashtu, të kuptohet se sa ka ndikuar në rritje të çmimeve të lëndës së parë dhe produkteve finale. Një komponent tjetër që është analizuar ka qenë aftësia konkurruese e bizneseve pasi është përcaktuar kjo masë dhe kapaciteti i prodhuesve vendor për të përmbushur nevojat e konsumatorëve për pemë dhe perime.

Procesi i anketimit është kryer gjatë një periudhe një javore dhe gjatë këtij procesi është siguruar informacioni i mjaftueshëm dhe i duhur për të krijuar mundësin Odës Ekonomike të Kosovës për të analizuar situatën si duhet.


Analizë/rezultatet e pyetësorit

Analizë e përgjithshme

Bazuar në të gjeturat e këtij hulumtimi rreth 41% e kompanive kanë deklaruar se me vendosjen e masës mbrojtëse nga shteti, e cila parasheh që të paguhet 30% e vlerës doganore për pemët dhe perimet që importohen do të mbrohen prodhuesit vendor. Përqindje të njëjtë ndajnë edhe kompanitë të cilat kanë potencuar se vendosja e kësaj mase nuk do të mbrojë prodhuesit vendor.




Oda Ekonomike e Kosovës ka analizuar efektin që ka kjo masë mbrojtëse te kompanitë që merren me prodhim, përpunim dhe tregti të pemëve dhe perimeve. Nga kjo analizë del se te 53% e kompanive kjo masë ka pasur një efekt negativ, ndërsa te 29% e kompanive që kanë qenë pjesëmarrëse në hulumtim ka pasur efekt pozitiv. Rreth 18% e tyre kanë deklaruar se performanca e kompanisë nuk është ndikuar nga vendosa e kësaj mase.




Pas caktimit të kësaj mase të përkohshme rreth 41% e kompanive kanë deklaruar se kanë rritur çmimet e produkteve që ata ofrojnë, rritje të çmimeve kanë pasur kryesisht kompanitë që si veprimtari të tyre kryesore e kanë tregtinë dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve. Ndërsa, 59% kanë deklaruar se kjo masë nuk ka pasur ndonjë efekt te çmimet.

Rritja mesatare e çmimeve për produktet që ka prekur masa mbrojtëse është 21.6%.




Një komponent tjetër që është analizuar është kostoja e lëndës së parë. Rreth 56% e kompanive kanë theksuar se kanë pasur një rritje të kostonë së lëndës së parë pas caktimit të masës mbrojtëse për pemë dhe perime. Ndërsa, 44% kanë deklaruar se nuk kanë pasur ndryshim në kosto. Rreth 71% e kompanive që merren me përpunimin e pemëve dhe perimeve kanë deklaruar se çmimi i lëndës së parë është rritur. Pjesa tjetër prej 29% që nuk kishin rritje të çmimit, ishin kompani që furnizoheshin me lëndë të parë nga prodhuesit vendor.




Aftësia konkurruese e kompanive kosovare është ndikuar nga caktimi i kësaj mase mbrojtëse të përkohshme, ku 44% e tyre kanë pohuar se ka ndikuar në rritje të aftësisë konkurruese. Ndërsa 56% kanë thënë se nuk ka pasur ndikim në këtë aspekt. Rritje të aftësisë konkurruese kishin kryesisht kompanitë që merren me prodhim dhe ato me përpunim të cilat kanë kontrata për furnizim me prodhuesit vendor të pemëve dhe perimeve.




Bazuar në evidencën e marrë nga kompanitë rreth 56% e tyre kanë theksuar se nuk ka prodhim vendor të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e konsumatorëve për pemë dhe perime. Ndërsa, 31% theksuan se prodhuesit vendor kanë kapacitet për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve. Analizuar në aspekt sektorial kompanitë që operojnë në sektorin e tregtisë, përkatësisht, rreth 80% e tyre kanë deklaruar se nuk ka prodhim të mjaftueshëm.



Sa i përket afatit kohor që është caktuar kjo masë mbrojtëse, rreth 69% e kompanive kanë potencuar se kjo masë nuk është ndërmarrë në kohë të duhur, dhe se ka dëmtuar kompanitë pasi që tashmë këto kompani kanë nënshkruar marrëveshje me furnitor të jashtëm.



Rreth 75% e kompanive të anketuara mendojnë se vendosja e kësaj mase nga shteti e dëmton ekonominë e lirë të tregut dhe nuk është në pajtim me marrëveshjen CEFTA.




Kompanitë kosovare gjatë procesit të anketimit janë pyetur rreth efekteve konkrete që janë shfaqur pas vendosjes së kësaj mase, shumica e tyre kanë treguar se janë përballur me një rritje të çmimit si në lëndë të parë ashtu edhe në çmimin e produkteve finale, rrjedhimisht në zvogëlim të marzhës së fitimit dhe sasisë më të vogël të shitur. Kompanitë që kanë deklaruar se kanë pasur efekte pozitive ishin kompanitë që i përkasin sektorit të prodhimit të pemëve dhe perimeve, e që e gjithë kjo kishte ndikuar në rritje të aftësisë konkurruese të këtyre kompanive.

Analizë sektoriale


Sektori prodhues i pemëve dhe perimeve

Rreth 75% e prodhuesve vendor kanë deklaruar se me vendosjen e kësaj mase mbrojtëse do të mbrohet veprimtaria e tyre prodhuese dhe produktet e tyre në përgjithësi.




Asnjë kompani e anketuar që merret me prodhimin e pemëve dhe perimeve nuk ka deklaruar se ka pasur rritje të çmimeve të produkteve që ata ofrojnë pasi është vendosur kjo masë.

A ka ndikuar në rritje të çmimeve ?




Gjysma e kompanive pjesëmarrëse në hulumtim kanë potencuar se caktimi i masës mbrojtëse nga shteti për të mbrojtur produktet kosovare ka ndikuar në rritje të aftësisë së tyre konkurruese.

A ka ndikuar në rritje të aftësisë konkurruese?




Sektori përpunues i pemëve dhe perimeve

Efekt pozitiv kishin vetëm 25% e kompanive që merren me përpunim të pemëve dhe perimeve. Bazuar në të gjeturat e nxjerra, duket se kjo masë ka pasur efekt negativ te 62% e kompanive të anketuara të këtij sektori. Vetëm 13% e kompanive nuk ishin ndikuar nga caktimi i kësaj mase.



Efektet negative janë shfaqur si pasojë e rritjes së çmimit të lëndës së parë dhe çmimit final të produkteve që ofrojnë këto kompani.

Mbi 70% e kompanive të sektorit të përpunimit të pemëve dhe perimeve kishin rritje të çmimit të lëndës së parë.



Rreth 86% e kompanive kanë deklaruar se caktimi i masës mbrojtëse që parasheh të paguhet 30% e vlerës së doganës për pemët dhe perimet që importohen ka ndikuar në rritje të çmimit të shitjes, e gjithë kjo në krahasim të konsumatorit.




Mbi 70% e kompanive të përfshira në proces të anketimit kanë deklaruar se caktimi i masës ka ndikuar në rritje të aftësisë konkurruese.



Sektori i tregtisë i pemëve dhe perimeve


Përqindje të njëjtë ndajnë kompanitë që kanë deklaruar se kanë pasur efekt negativ dhe neutral, respektivisht 40%. Efekt pozitiv kishte vetëm te 20% e kompanive që operojnë në këtë sektor.




Pas caktimit të masës mbrojtëse rreth 80% e kompanive që merren me tregtimin e pemëve dhe perimeve kanë theksuar se kanë rritur çmimet e produkteve që janë prekur nga masa mbrojtëse në import.



Asnjë kompani që operon në sektorin e tregtisë nuk ka deklaruar se ka prodhim vendor të mjaftueshëm për të përmbushur nevoja e konsumatorëve për peme dhe perime.



Rreth 80% e kompanive kanë thënë se masa mbrojtëse nuk është ndërmarrë dhe implementuar në kohë të duhur.



Përmbledhje e përgjithshme / Konkluzione

Për qëllime të këtij hulumtimi është mbledhur informacion nga niveli i lartë i menaxhmentit të kompanive pjesëmarrëse, ky hulumtim është kryer me qëllim të matjes së efekteve që ka masa mbrojtëse për peme dhe perime në kompanitë që si veprimtari kryesore e kanë prodhimin, përpunimin dhe tregtinë e pemëve dhe perimeve. Për realizimin e kësaj analize është përdorur një mostër prej 15 kompanive, mostra është ndarë në tri pjesë.

Bazuar në të gjeturat e këtij hulumtimi rreth 41% e kompanive kanë deklaruar se me vendosjen e masës mbrojtëse nga shteti, e cila parasheh që të paguhet 30% e vlerës doganore për pemët dhe perimet që importohen do të mbrohen prodhuesit vendor. Përqindje të njëjtë ndajnë edhe kompanitë të cilat kanë potencuar se vendosja e kësaj mase nuk do të mbrojë prodhuesit vendor.

Nga kjo analizë del se te 53% e kompanive kjo masë ka pasur një efekt negativ, ndërsa te 29% e kompanive që kanë qenë pjesëmarrëse në hulumtim ka pasur efekt pozitiv. Rreth 18% e tyre kanë deklaruar se performanca e kompanisë nuk është ndikuar nga vendosa e kësaj mase.

41% e kompanive kanë deklaruar se kanë rritur çmimet e produkteve që ata ofrojnë, rritje të çmimeve kanë pasuar kryesisht kompanitë që si veprimtari të tyre kryesore e kanë tregtinë dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve. Ndërsa, 59% kanë deklaruar se kjo masë nuk ka pasur ndonjë efekt të çmimit.

Rritja mesatare e çmimeve për produktet që ka prekur masa mbrojtëse është 21.6%.

Rreth 56% e kompanive kanë theksuar se kanë pasur një rritje të kostos së lëndës së parë pas caktimit të masës mbrojtëse për peme dhe perime.

Aftësia konkurruese e kompanive kosovare është ndikuar nga caktimi i kësaj mase mbrojtëse të përkohshme, ku 44% e tyre kanë pohuar se ka ndikuar në rritje të aftësisë konkurruese. Rritje të aftësisë konkurruese kishin kryesisht kompanitë që merren me prodhim dhe ato me përpunim të cilat kanë kontrata për furnizim me prodhuesit vendor të pemëve dhe perimeve.

Bazuar në evidencën e marrë nga kompanitë rreth 56% e tyre kanë theksuar se nuk ka prodhim vendor të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e konsumatorëve për pemë dhe perime.

69% e kompanive kanë potencuar se kjo masë nuk është ndërmarrë në kohë të duhur, dhe se ka dëmtuar kompanitë pasi që tashmë këto kompani kanë nënshkruar marrëveshje me furnitor të jashtëm.

Kompanitë kosovare gjatë procesit të anketimit janë pyetur rreth efekteve konkrete që janë shfaqur pas vendosjes së kësaj mase, shumica e tyre kanë treguar se janë përballur me një rritje të çmimit si në lëndë të parë ashtu edhe në çmimin e produkteve finale, rrjedhimisht në zvogëlim të marzhës së fitimit dhe sasisë më të vogël të shitur.

Shikuar në një perspektiv sektoriale, gjysma e kompanive që i përkasin sektorit të prodhimit të pemëve dhe perimeve kanë potencuar se caktimi i masës mbrojtëse nga shteti për të mbrojtur produktet kosovare ka ndikuar në rritje të aftësisë së tyre konkurruese.

Rreth 71% kompanive pjesëmarrëse në hulumtim të cilat merren me përpunimin e pemëve dhe perimeve kanë deklaruar se çmimi i lëndës së parë është rritur. Sa i përket këtij sektori efekt pozitiv kishin vetëm 25% e kompanive, ndërsa efekti negativ është vërejtur te 62% e kompanive të anketuara të këtij sektori.

Pas caktimit të masës mbrojtëse rreth 80% e kompanive që merren me tregtimin e pemëve dhe perimeve kanë theksuar se kanë rritur çmimet e produkteve që janë prekur nga masa mbrojtëse në import.